

PORTRET KËNGËTARI

NJË KËNGËTAR I RI NË NDIHMË TË POEZISË SË DIASPORËS

David Stanaj, ndonëse është vetëm 19 vjeç, ai ka regjistruar dy albume muzikore me këngët e tij më të mira.

Është kreu e natyrshme që muzika të kërkojë diçka të poezia. Është po aq e natyrshme që këngëtarët të jenë të interesuar për fatin e poetëve. Sepse poezia ekziston në mes të muzikës dhe gjuhës.

Të paktën këngëtar i ri David Stanaj mendon kështu. Davidi nuk është një 19-vjeçarë i zakonshëm. Fillimet e tij të Para drejt jetës së artistit na sygjerojnë një të ardhme mjaft premtuese për të. Mbi të gjitha ai është artist, artist në shpirt, në kuptimin më njerëzor të fjalës.

Një nga karakteristikat që e shkëputë këtë djalosh nga turma e të rinjëve tjerë është koncepti dhe dashuria paralele që ka për muzikën dhe poezinë. Ndonëse vetëm 19 vjeç, ai ka regjistruar dy albume muzikore me këngët e tij më të mira. Talenti, në njërin anë, dhe puna e tij e madhe për formimin e tij si këngëtar, në anën tjetër, tani kanë filluar t'i japin frutet e para për të, si individual, dhe për shqiptarët e amerikës, si komunitet.

Sot krijimtaria e poeteve të diasporës është në një vorbull të trazuar. Poetët janë në një gjendje të acaruar psikologjike: sa më shumë që të krijojnë, aq më shumë do u duhet të paguajnë për botimin e veprave të tyre. Pra jetojnë një realitet sfinks: duhet të punojnë që të mbajnë veten dhe familjen, pastaj të punojnë për të botuar veprat e tyre letrare, pa harruar se diku në mes të së parës dhe të dytës, ata duhet të gjenjë kohë për të krijuar.

Të paktën sipas Davidit, me muzikën dhe muzikantët e diasporës është e kundërta. Tani për tani ai ka një zanafillë me të cilën bën qejf dhe fitime. Si njëri prej këngëtarëve të grupit muzikorë "Malësori", ai gjendet mjaft i okupuar me argëtimin që kërkon komunitet në raste gëzimesh familjare apo në raste tubimesh me karakter festiv.

Davidi ka një zë të pastër. Por, si për të gjithë këngëtarët seriozë, notat muzikore, elementi melodik, niveli i harmonisë dhe pasuria kompozicionale e çdo veprave muzikore edhe për të kanë një rëndësi personale dhe profesionale të jorëndomtë.

Megjithëse të dyja albumet, nga niveli artistik, janë të ndërtuara me modesti, lënda muzikore e paraqitur aty na udhëheqë drejt përpjekjeve të Davidit për t'u shfaqur si artist me përgjegjësi se seder profesionale. Evidencë për këtë janë si freskia e burimeve tonale, gjerësia dinamike e temave ashtu dhe pasuria melodioze e këngëve të tij.

Ai shpreson se pavarësisht nga ambienti që e rrethon, kënga e tij do të mbetet brenda kufijve artistik dhe të klimës së pastër të muzikës tradicionale shqiptare. Ai do që muzika e tij të ketë një esencë të mjaftueshme artistiko-tradicionale që të përmbushë kërkesat që bashkëkohësit e tij kanë ndaj muzikës.

Sidomos për ata që janë të dashuruar pas muzikës popullore të zonës së Veriut, zëri i ëmbël i David Stanajt

bëhet pa sforcime pjesë e qenies së tyre. Ndër të tjera, ata gjejnë në muzikën e re të tij trajtimin e temave të atdhedashurisë, mallit për tokën shqiptare dhe një buqetë të larmishme këngësh për dashurinë.

Ndryshe nga poezia, muzika është një fenomen që haptazi nuk zbaton as nuk thyen ligje. Por ashtu si poezia, ajo nuk ndjehet kurrë inferiore para formave të tjera të artit. Bashkimi i të dyjave bën të mundshme eliminimin e asaj vije të hollë që shërben si kufi midis formave të artit që ato u përkasin.

I frymëzuar nga përfaqësuesit dhe fuqia që kanë në vetvete këto dy forma të rëndësishme të artit, Davidi shprehet kështu: "Muzika i bashkangjitet poezisë që mesazhi që sjellë poezia të bëhet më argetues".

Dhe nuk ke se si të mos pajtohesh me të. Muzika dhe poezia nuk janë si një veshtrim drejt horizontit, që sa më larg të shikosh aq më të vogla dhe të tjetërsuara të duket objektet. Të dyja kanë provuar të kundërtën. Po t'i besojmë Moxartit (1791 - 1856) mësojmë se: "Muzika gjithmonë ka qenë ushqim për dashurinë dhe dashuria ushqim për muzikën." (Nga libri "Bota e Mendimeve" faqe 52). Për këngëtarin tonë, poezia zëvendëson fjalën dashuri në thenien e Moxartit.

Është e admirueshme magjepsja e tij pas bukurive ëndërrorë të muzikës dhe të poezisë. Për të muzika dhe poezia janë dhe do të mbeten gjithmonë mësim në vazhdim. "Muzika është aq sa e bukur edhe me fat", thotë Davidi. "Ndryshe nga poezia" - vazhdon ai, "muzika gjend vend në një rreth me të gjerë njerëzish. Nuk ka nevojë për shkollë të pëlqehet, deri në një masë, ajo. Kështu muzika gëzon një masë më të madhe publike. Si e tillë, natyrisht, ajo ka mundësi më të mëdha shitje. Por pa poezinë, sidomos poezinë popullore këngët do të mbeteshin me një mangësi të madhe".

Për këtë Davidi është i ndërgjegjshëm. Ndaj dashurinë dhe respektin që ka për poezinë nuk e shpreh vetëm me fjalë. Siç e thamë më lart,



Albumi e gëzofsh lirinë Kosovë i David Stanajt

ai ka regjistruar dy albume me këngë nga repertori i tij modest. Nga ana tjetër, në shenjë vlerësimi për pjesën e domosdoshme që sjellë poezia të kënga e tij, me fitimet që ka nxjerrë nga këto albume, gjer tani, ai ka sponsoruar tri libra me poezi, nga tre poet të ndryshëm. Ja një fragment nga biseda jonë me të për këtë çështje:

"Poezia dhe letërsia janë rrenjë e kulturës se një kombi. Unë dua që letërsia të përparojnë, që edhe kombi të përparojnë. Kështu, sa here që të kem mundësi financiare, do të vazhdoj të sponsoroj vepra letrare të poeteve dhe shkrimtareve tonë të diasporës".

Ja si një artist mund të konsiderohet "dy herë artist", pavarësisht nga mosha. Nisma e Davidit është një pozicion shumë admirues. Megjithëse, siç thotë populli "me një lule nuk del pranvera", të shikosh një këngëtarë të vënë në ndihmë të poezisë është një fillim i mbarë.

Vërtet, nuk ka gjë më të bukur për artistët e një brezi se, si lëvrues të fushave të ndryshme të artit, të bashkohen forcat dhe të krijojnë një gjuhë unike dhe të përbashkët; gjuhën e dashurisë për njëri-tjetrin, gjuhën e dashurisë për artin.

Gjekë Marinaj

FALENDERIM

Në emër të Kuvendit të Komunës së Therandës dhe në emrin tim i falenderoj bashkëatdhetarët tanë me qëndrim të përkohshëm në Zvicër për kontributin e tyre në mjete materiale për ngritjen e lapidarit të ish Kryetarit të KK-Therandë Ukë Bytyçit, si dhe për ndihmat solidare për familjet e Ukë Bytyçi, Bajram Bytyçi dhe Bafti Bajramit.

Falenderojmë z. Tarzan Kabashi, Gani Berisha dhe Ali Gashi nga Theranda. Ferat Gashi, Adem Gashi, Islam Makica, Xhemal Makica, Nazif Gashi, Shpejtim

Gashi, Daut Gashi, Islam Binaku, Shefki Kabashi, Sadri Përzhaku, Sevdil Kabashi dhe Ibrahim Gashi nga Studenqani. Azem Hoxha dhe Besim Hoxha nga Semetishti. Feriz Kadrija nga Budakova, Sedat Sahitaj dhe Gëzim Sahitaj nga Sopia. Milaim Muji, Syl Avdullahu dhe Vesel Berisha nga Gjilani. Shaqir Hoxha nga Prizreni. Hadi Dina nga Celina. Raif Krasniqi nga Kamenica. Shukri Krasniqi nga Hoqa e Vogël dhe Qemal Morina nga Samadraxha.

Kryetari i Kuvendit, Sali Asllanaj

DISA BASHKATDHEARË NGA RETHINA E KUMANOVËS QË JETOJNË NË ZÜRICH JANË TË SHQETËSUAR ME SITUATËN NË MAQEDONI

SITUATA E TENSIONUAR NË MAQEDONI NDIHET SHUMË TË BASHKATDHEARËT TANË

Këta tre bashkatdhetarë duke shpejtuar me shfletimin e faqeve të gazetës ndalen te faqet e Maqedonisë dhe e lexojnë shkronjë për shkronjë çdo artikull. Duke lexuar shihet qartë një ofshamë e madhe që vjen nga shpirti i tyre. Edhe në pamjen e ajshme dukeshin shumë të lodhur. U afruam dhe e bëmë një bisedë me Agimin, Besnikun dhe Orhanin që ishin nga rrethina e Likovës dhe Kumanovës.

Zürich 5 shtator

Situata e tensionuar në rajonin e Likovës, Kumanovës dhe Haraçinës, ka bërë që shumë mërgimtarë që jetojnë dhe punojnë në Zvicër dhe gjetiu, që të shqetësohen dhe presin se çfarë do të ndodhë në atdhe. Përpos punës së përditshme dhe të lodhshme, këta bashkatdhetarë mundohen edhe në orar të punës që të „vjedhin“ një pesë minutësh dhe të dëgjojnë, apo lexojnë ndonjë lajm aktual për në vendlindje. Disa bashkatdhetarë që jetojnë në rrethinë e Zürichut dhe vijnë nga vendet e krizës nga Likova dhe Kumanova, i takuam në Oerlikon që kishin dalur për të blerë gazetën „Bota sot“ dhe për t'u informuar më përsëafërmi me situatën që po mbretëron në Maqedoni. Këta tre bashkatdhetarë duke shpejtuar me shfletimin e faqeve të gazetës ndalen te faqet e Maqedonisë dhe e lexojnë shkronjë për shkronjë çdo artikull. Duke lexuar shihet qartë një ofshamë e madhe që vjen nga shpirti i tyre. Edhe në pamjen e ajshme dukeshin shumë të lodhur. U afruam dhe e bëmë një bisedë me Agimin, Besnikun dhe Orhanin që ishin nga rrethina e Likovës dhe Kumanovës. Me të kuptuar se jemi nga gazeta kombëtare „Bota sot“ na u afruan dhe kërkonin ndonjë lajm më të freskët për në Likovë, Kumanovë dhe Haraçinë. Ne i ndihmuam duke i thënë: „Bota sot“ i ka dy faqe special për Maqedoninë dhe kemi korespondentë nga këto qytete dhe lajmet janë të freskëta.

Tre shqiptarë nga fshati Malinë të Likovës janë viktimat e para të dhunës policore maqedonase kohët e fundit. Xhezair Shabani dhe dy

djemtë e tij kanë deklaruar se plotë 30 orë janë keqtrajtuar nga forcat speciale. Edhe pse anëtarët e familjes Shabani kishin dalë në mal për të prerë dru, policia ka kërkuar të dy nga ata se ku gjendet Abdul Jakupi i njohur si komandant "Çakalla". Policia e Maqedonisë ka filluar të heqë pikat e kontrollit rreth fshatrave Vaksincë dhe Llojan në rajonin e Kumanovës, pasi banorët kanë dhënë garancione se në fshatrat e tyre nuk ka persona të armatosur. Reduktimi i forcave të policisë speciale maqedonase nga kjo zonë është rezultat i kompromisit të takimit të Kumanovës mes përfaqësuesve shqiptar, atyre maqedonase dhe ndërkombëtarë. Po dje ka fillura edhe kthimi i banorëve në shtëpitë e tyre, të cilët ishin larguar nga frika e ndonjë konflikti të mundshëm të armatosur në këtë pjesë të Maqedonisë, e banuar kryesisht me shqiptarë. Këta bashkatdhetarë duke e parë realitetin që po mbretëron në Maqedoni, u ndanë të kënaqur me lajmet që janë te „Bota sot“ dhe vazhduan rrugën për të shkuar në orar të punës, duke na uruar punë të mbarë dhe suksese në jetë. Bashkatdhetarët edhe në luftën e para disa viteve, ishin të shqetësuar dhe shumë të lënduar me luftën që u zhvillua atje dhe këta bashkatdhetarë me gjitha forcat që posedonin jepnin ndihma për atdheun. Me të përfunduar lufta në Maqedoni, Kosovë, Kosovë Lindore, menduan se më nuk do të ketë situata të tensionuara në adhe. Jeta e mërgimit bëhet edhe më e vështirë me situata të kësaj natyre.

D.HEBIBI

TË NDIHMOJMË NGRITJEN E SHTATORES PËR UKË BYTYÇIN

Duke u bazuar në nenin 47 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Therandës, Kryetari i Kuvendit dhe autorizim për mbledhjen e ndihmave dedikuara ngritjes së shtatores së Ukë Bytyçit:

Asambleja Komonale e Therandës në takimin e saj të mbajtur me datën 2.12.2002 mori vendim mbi ruajtjen e emrit dhe veprës së ish Kryetarit Ukë Bytyçit ku u vendos që të ndërtohet shtatorja para Kuvendit të Komunës. Mirëpo faktori ndërkombëtar nuk lejon që kjo shtatore të financohet ekskluzivisht nga buxheti i komunës për këtë qëllim jemi të shtërnguar që të

kërkojmë donacione nga bashkëatdhetarët tanë. Këshilli Organizativ për ngritjen e shtatores të ish Kryetarit të KK Therandë Ukë Bytyçi i formuar me datën 15.1.2003 autorizon Gani Berishën dhe Tarzan Kabashin që të bëjnë grumbullimin e mjeteve materiale nga bashkatdhetarët që gjinden në Zvicër

KRYETARI I KUVENDIT* Sali Ahmetaj